



KOLEGJI ESLG

Procesverbali i Bordit Industrial të Programit

Pranishëm: Gent Sejdiu (CEO i KRG), Bajram Hoxha (CEO i Hoxha Invest Group) dhe Arben Asllani (Intercapital)

Bordi Industrial i Programit mbajti takim më 21.10.2020 për të rishikuar rezultatet e mësimnxënies dhe planprogramin e programit Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) dhe i dha detyrën Z. Gent Sejdiu të shërbejë si procesmbajtës.

Bordi Industrial i Programit rishikoi raportin mbi vlerësimin e rezultateve të mësimnxënies të propozuara i cili është në dispozicion online në http://www.eukos.org/repository/docs/Program_Learning_Outcomes_for_Bachelor_Program_2020.pdf

Bordi Industrial i Programit gjithashtu rishikoi draftin final të rezultateve të propozuara të mësimnxënies nga Ekipi i Zhvillimit të Kurrikulës së Kolegjit ESLG, të cilat janë aprovuar nga përfaqësuesit e industrisë ndërtimore në mbledhjet e përbashkëta me Ekipin e Zhvillimit të Kurrikulës. Në këtë takim, anëtarët e Bordit Industrial të Programit miratuan përfundimet e mbledhjes së përbashkët ndërmjet të Bordit Industrial të Programit dhe Ekipit të Zhvillimit të Kurrikulës i cili mund të shihet në faqen 9 të Procedurës për Aprovimin e Kurrikulës që është në dispozicion online në http://www.eukos.org/repository/docs/Procedure_of_approval_of_review_of_curricula_2020.pdf

Bordi Industrial i Programit rishikoi propozimet për rezultatet e mësimnxënies së programit të ri Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës dhe përfundoi se rezultatet e mësimnxënies janë në pajtim me shkathtësitë e kërkuara nga industria për të shkëlqyer pas diplomimit dhe janë në pajtim me Kornizën Kosovare të Kualifikimit dhe Kualifikimet për Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë për Nivelin 6.

Bordi Industrial i Programit konstaton se rezultati i mësimnxënies Mbledh dhe interpreton të dhënat e transaksioneve financiare të investimeve në paluajtshmëri ka pranuar 65 % pranueshmëri nga sondazhi me përfaqësuesit e industrisë dhe se ky rezultat i mësimnxënies shton vlerë biznesit vetëm nëse investimet reale në paluajtshmëri përfshihen në planprogram dhe si pjesë e vlerësimit studentor.

Prishtinë

**Prishtinë on:
21 tetor
2020**

Procesmbajës:

Gent Sejdiu



